



KOLEGJI AAB – PRISHTINË
Programi Komunikim Masiv dhe Gazetari (MA)
Dekanatit

Programi për Studimet: Master

Emri i programit te Masterit: Komunikimi Masiv dhe Gazetaria

Lënda: Kërkesë për lejimin e punimit te diplomës, tezat dhe projekt temën e masterit

Kandidati: Azem Osmani nga Podujeva

Titulli i Temës: Informimi dhe konsumimi mediatik në komunën e Podujevës

Propozimi për mentor: Dr. Sc. Hasan Saliu

Përshkrimi i shkurtër i temës:

Objekt studimi i këtij punimi të Masterit, është gjendja aktuale e informimit dhe konsumimit medial në komunën e Podujevës. Kapacitetet mediale që u ofrohen qytetarëve, pastaj kanalet e komunikimit që ata i konsumojnë. Shtrirja gjeografike e rrjetit medial në zonat urbane, rurale dhe të rurale të thella për të shikuar gjendjen e mbulimit mediatik. objekt tjetër i studimit në këtë punim do të jetë informimi në aspektin cilësor dhe sasior, për të shikuar pastaj se nga cilat kanale të komunikimit ata informohen më shumë.

Punimi i masterit lidhur me këtë temë ka një arsye mjaftë të mirë pasi do të krijohet një pasqyrë reale e gjendjes së informimit dhe konsumimit medial. Nga kjo do të mund të përfitojë Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim e Komunës së Podujevës, për të marr hapa në përmirësimin e gjendjes, në bazë të kompetencave të tyre. E njëjta gjë do të vlej edhe për transmetuesit televiziv, e sidomos për dy radiot lokale ekzistuese në rajonin e Llapit, për operatorët e sistemit kabllorë dhe të internetit, për të përmirësuar politikat e tyre në drejtim të përmirësimit të shërbimeve të tyre në interes të konsumatorëve medial. dhe krejt kjo do jetë në favor të përmirësimit të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve mediale për qytetarët e komunës së Podujevës që ata të kenë mundësi më të mira për tu informuar.

Prishtine,
Data, 25.04.2014

Nënshkrimi i kandidatit
Azem Osmani